



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKT- LIGJ

Nr.____, datë _____.__ 2020

**PËR REGJISTRIMIN, MËNYRËN E PËRDORIMIT
DHE KONTROLLIN E MJETEVE LUNDRUESE TURISTIKE DHE TË
KËNAQËSISË ME MOTOR ME FUQI MBI 30 KW OSE 40.8 KF DHE TONAZH
NËN 150 GT**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

PJESA E PARË

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj rregullon mënyrën e regjistrimit, të përdorimit dhe të kontrollit të mjeteve lundruese turistike dhe të kënaqësisë me motor mbi 30 KW ose 40.8 KF dhe tonazh nën 150 GT.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimin e këtij ligji përkufizimet kanë këto kuptime:

1. Mjet Lundrues Kënaqësie – nënkupton një mjet lundrues me tonazh nën 150 GT, që ka një fuqi të përgjithshme të motorit ose të motorëve më të lartë se 30 kilovatë/orë ose 40,8 kuaj/fuqi HP, të klasifikuar si të tillë nga Regjistri Detar Shqiptar ose nga institucionet korresponduese të shteteve të tjera dhe që përdoret për qëllime turistike dhe kënaqësie.
2. Mjet Lundrues Turistik – nënkupton një mjet lundrues që përdoret për qëllime turistike
3. Regjistrim – nënkupton regjistrimin fillestarë i mjeteve lundruese në regjistrin fizik të pronësisë.

4. Regjistri Elektronik i Mjeteve Lundruese – nënkupton kopjon elektronike të regjistrimit fizik të mjeteve lundrues.
5. Dëshmi Pronësie dhe Dëshmi Flamuri (Certifikatë Regjistrimi) - nënkupton dokumentet që përfitohen pas regjistrimit të pronësisë për mjete lundruese mbi 15 ml.
6. Dëshmi Lundrimi për Mjete të Vogla Lundruese – nënkupton dokumentin e pronësisë dhe flamurit për mjete të vogla lundruese deri në 15 ml,
7. Dëshmi Drejtimi për Mjete të Vogla Lundruese – nënkupton dokumentin e aftësisë së drejtimit të mjetit
8. Certifikatë Sigurie – nënkupton dokumentin e lëshuar nga Shoqëria Klasifikues, për klasifikimin e mjetit
9. ZRMLD - nënkupton Zyrën e Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare
10. Sistemi i posaçëm elektronik për lëvizjen e mjeteve Lundruese – nënkupton sistemin elektronik të raportimit të mjeteve të përshkruara në këtë ligj.
11. Hapësira detare”, përfshin detin e brendshëm dhe detin territorial të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të Konventës së OKB-së mbi të drejtën e Detit, 1982, ratifikuar me ligjin nr.9055, datë 24.4.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën mbi të drejtën e detit”, të OKB-së”.
12. “Deti i brendshëm”, përfshin hapësirën detare në drejtim të tokës që përfshihet midis vijës së drejtë bazë dhe bregdetit.
13. “Deti territorial”, përfshinë hapësirën detare nga vija e drejtë bazë në drejtim të detit deti në distancën 12 milje detare ose vijën delimituese të arritur me marrëveshje me fqinjët detarë
14. “Ujëra të brendshme tokësore” ose “Ujëra të brendshme”, përfshijnë edhe hapësirat ujore në territorin tokësor: lumenjtë, liqenet, rezervuarët, kënetat, etj.
15. “Shelf kontinental”, përfshinë tabanin e fundit të detit dhe nëntoka poshtë tij përtej kufijve të detit territorial deri në vijën delimituese të arritur me marrëveshje me fqinjët detare.
16. “Zonë ekskluzive ekonomike”, përfshinë kolonën e ujit të hapësirës detare të detit përtej kufijve të detit territorial deri në vijën delimituese të arritur me marrëveshje me fqinjët detare.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për mjetet lundruese, objekt i këtij ligji, që mund të përdoren në hapësirën detare shqiptare dhe ujërat e brendshme tokësore.
2. Ky ligj nuk zbatohet për mjetet lundruese në përdorim të forcave të armatosura, të kapitenerisë së porteve, të forcave të policisë, të doganave dhe të organeve të tjera të parashikuara me ligj.

PJESA E DYTË

Neni 4

Respektimi i normave të lundrimit

1. Mjetet lundruese objekt i këtij ligji duhet të respektojnë rregullat e regjimit të lundrimit në det dhe në ujërat e brendshme tokësore, duke përfshirë dhe normat që lidhen me pajisjet e shpëtimit, me sinjalet ndriçuese për lundrimin natën, me pajisjen me radiondërlidhjeje, të sintonizuar në frekuencat e ndihmës detare, si dhe me sistemin për lokalizim gjeografik, GPS, sipas certifikatës së sigurisë së mjetit”.

Neni 5

Detyrimi i përgjithshëm

1. Mjetet lundruese, objekti i këtij ligji, në çdo rast duhet të kenë në bord dhe të paraqesin me kërkesën e autoriteteve përgjegjëse dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Dokument identifikimi të personit/personave, drejtuesit dhe personave në bord;
 - b) Certifikatën e sigurisë të mjetit lundrues;
 - c) Dëshmia e Aftësisë së lundrimit për mjetin e vogël lundrues/Dëshmi Pronësie/Dëshmi flamuri;
 - ç) Dëshmi Aftësie Drejtimi për mjetin e vogël lundrues;
 - d) Policën e sigurimit për dëmet ndaj të tretëve;
2. Mjetet lundruese me fuqi motorike më të vogël se 30 KW ose 40.8 hp me distancë lundrimi deri në 2 milje nga bregu, regjistrohen vetëm në zyrën e ZRMLD;
3. Këto mjete zbatojnë të gjitha rregullat dhe detyrimet e sigurisë e të lundrimit, përgjigjen për shkeljet ligjore sipas sanksioneve të parashikuara në këtë ligj, por përjashtohen nga pajisja me dëshminë e aftësisë për drejtuesin dhe pajisjen me sistemin GPS.

Neni 6

Njoftimi për operimin e mjetit lundruese

1. Mjetet lundruese të kënaqësisë dhe ato turistike njoftojnë në nisje dhe mbërritje;
2. Njoftimi për hyrjen dhe daljen apo lëvizjen në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë, bëhet në sistemin posaçëm elektronik të lëvizjes së mjeteve lundruese
3. Njoftimi për lëvizje duhet të përfshijë:
 - a) Emri i mjetit, Numri Regjistrimit;
 - b) Emri pronarit/Drejtesit të mjetit;
 - c) Ora e përafërt e nisjes/mbërritjes;
 - d) Destinacioni;
 - e) Numri dhe gjeneralitetet e personave në bord.

Neni 7

Regjistri Elektronik i Mjeteve Lundruese

1. Drejtoria e Përgjithshme Detare krijon, mirëmban dhe përditëson Regjistrin Elektronik të mjeteve lundruese;

2. Në këtë sistem do të kenë të drejta aksesi organet shtetërore të njohura me ligj si:
 - a) Gjykata;
 - b) Prokuroria;
 - c) Policia e Shtetit;
 - d) Roja Bregdetare; etj.
3. Regjistri Elektronik i Mjeteve Lundruese do të vendoset në funksion brenda 1 vit nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
4. Deri në vënien në operim të Regjistrimit Elektronik shkëmbimi i informacionit me institucionet ligjore do të kryhet me kërkesën me shkrim drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Detare nga institucioni i interesuar.
5. Rregullorja për funksionimin e Regjistrimit Elektronik do të miratohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin dhe ministrisë përgjegjëse për policinë e shtetit, pas propozimit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

PJESA E TRETË

Neni 8

Deklarimi pas importimit

1. Subjekti që importon një mjet lundrues, objekt i këtij ligji, përveç ndjekjes së procedurave doganore të parashikuara, duhet të bëjë deklarimin me shkrim, pranë pikave të kalimit kufitar, duke shënuar vendqëndrimin, vend bazimin e mjetit dhe gjeneralitetet e pronarit ose të bashkëpronarëve.
2. Brenda 10(dhjetë) ditëve nga importimi, pronari ose bashkëpronarët duhet të bëjnë regjistrimin e mjetit lundrues pranë ZMRLD.

Neni 9

Ndryshimi i kushteve dhe pronësisë

1. Çdo subjekt që përfiton ose mban, me çfarëdo titulli, një mjet lundrues ose pjesë të tij, duhet të bëjë deklarimin, brenda njëzet e katër orëve nga marrja në zotërim ose në mbajtje, në sistemin e posaçëm për deklarimin e lëvizjes së mjeteve duke shënuar gjeneralitetet dhe vendqëndrimin e tij, vend bazimin e përhershëm të mjetit, si dhe gjeneralitetet e pronarit ose të bashkëpronarëve.
2. Pronari ose bashkëpronarët e mjetit lundrues dhe personi i autorizuar, janë të detyruar të njoftojnë brenda njëzet e katër orëve në sistemin e posaçëm për deklarimin e lëvizjes së mjeteve, çdo ndryshim që ka të bëjë me një ose disa nga kushtet e mëposhtme:
 - a) ndryshimi i titullarit të pronës ose të përdorimit;
 - b) zëvendësimi i personit të autorizuar për drejtimin e mjetit ose përdoruesit të mjetit;
 - c) ndryshimi i vendbanimit së personave të mësipërm;
 - d) ndryshimi i vendbazimit të përhershëm të mjetit;
3. Pronari ose bashkëpronarët e mjetit lundrues dhe personi i autorizuar, janë të detyruar të bëjnë ndryshimin e pronësisë pranë ZMRLD brenda 10 (dhjetë) ditëve.

4. Brenda pesë ditëve nga paraqitja e njoftimit të ndryshimit, ZRMLD duhet të bëjë regjistrimin e ri dhe të lëshojë një Dëshmi të re Lundrimi.
5. Deri në lëshimin e Dëshmisë së re të Lundrimit, mjete lundrues nuk mund të zhvendoset nga vendi i ruajtjes, as të përdoret për çfarëdolloj qëllimi.
6. ZRMLD njëkohësisht me ndryshimet në regjistrat fizik bën dhe ndryshimin në regjistrin elektronik të mjeteve lundruese.

PJESA E KATËRT

Neni 10

Fabrikat dhe kantieret detare

1. Fabrikat dhe kantieret detare, që ndërtojnë, ristrukturojnë, riparojnë ose përfitojnë me çfarëdolloj titulli mjete lundruese, objekte të këtij ligji, mbajnë regjistrat përkatës për ndërtimin, rikonstruktimin dhe riparimin me fletë të numëruara, të vulosura e të firmosura nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.
2. Në regjistër duhet të shënohen, në mënyrë kronologjike e pa mbishkrime të palxueshme ose fshirje, të dhënat që kanë të bëjnë me çdo prodhim, ristrukturim e riparim, modeli, numri i matrikullës së prodhimit, emri i mjetit, gjeneralitetet e plota të blerësit të pronarit, të bashkëpronarëve ose të ceduesit dhe atij që e ka transportuar e dorëzuar mjetin lundrues.
3. Përgjegjësi i fabrikës dhe i kantierit detar është i detyruar ta paraqesë regjistrin, për qëllime kontrolli, sa herë që i kërkohet nga autoritetet policore dhe autoritetet të tjera shtetërore.

PJESA E PESTË

Neni 11

Mjetet lundruese të regjistruara jashtë shtetit

1. Shtetasi shqiptar, shtetasi i huaj ose pa shtetësi, pronar, ose mbajtës i mjeteve lundruese që nuk janë të regjistruar në Shqipëri, duhet të deklarojë në sistemin posaçëm të komunikimit në çastin e mbërritjes në port, përveç të dhënave të tjera, kohën e parashikuar të qëndrimit në ujërat territoriale shqiptare;
2. Përveç sa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni dhe detyrimeve të tjera që rrjedhin nga legjislacioni për lundrimin, pronarët ose mbajtësit e mjeteve lundruese, të regjistruara jashtë shtetit, të cilët duan të qëndrojnë në ujërat territoriale shqiptare për një periudhë më të gjatë se 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, i nënshtrohen detyrimit të regjistrimit;
3. Për regjistrimin e tyre duhet të paraqiten dokumentet sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin e mjeteve lundrues.

Neni 12

Kontrollet e mjeteve lundruese

Mbi bazën e Regjistrimit Elektronik të Mjeteve Lundruese dhe mbi bazën e analizës së riskut, Policia Kufitare ushtron kontrolle specifike sipas fushës së kompetencave në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, në lidhje me dokumentacionin dhe zbatimin e rregullave të lundrimit dhe të sigurisë të mjeteve lundruese, objekt i këtij ligji.

PJESA E GJASHTË

Neni 13 Ndalime

1. Ndalohet përdorimi i mjeteve lundruese të peregjistruara
2. Ndalohet përdorimi i mjeteve lundruese objekt i këtij ligji nga subjekte që janë dënuar për veprat penale në fushën e terrorizmit, trafikut të qenieve njerëzore, trafikut të lëndëve narkotike, armëve, lëndëve kimike dhe radioaktive dhe transporti i kundërligjshëm i mjeteve monetare

PJESA E SHTATË

SANKSIONET

Neni 14

Mos regjistrimi i pronësisë së mjetit brenda afatit

1. Mos regjistrimi i pronësisë së mjetit brenda afatit përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 20,000 (njëzet mijë) lekë.
2. ZRMLD zbaton sanksionin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni duke respektuar procedurën e parashikuar

Neni 15

Mospasja e dokumenteve gjatë lundrimit

1. Mospasja në bordin e mjetit lundrues, të dokumenteve të përmendura në nenin 5, gjatë kontrollit të autoriteteve ligj zbatuese, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me një gjobë 10.000 (dhjetë mijë) lekë.
2. Në rastin e parashikuar në pikën 1, mjeti lundrues i nënshtrohet bllokimit administrativ deri në verifikimin e identitetit të pronarit, të bashkëpronarëve, të mbajtësit, të zotëruesit ose të drejtuesit të mjetit lundrues.
3. Në procesverbalin e konstatimit të shkeljes, një kopje e të cilit i jepet zotëruesit ose mbajtësit të mjetit lundrues, duhet të shënohet detyrimi i pronarit, i bashkëpronarëve ose i drejtuesit të mjetit për t'ia paraqitur dokumentet e mësipërme, brenda 2 (dy) ditëve, zyrës së policisë kufitare që e procedon.
4. Nëse dokumentet nuk paraqiten brenda afatit të parashikuar në pikën e mësipërme, mjeti lundrues i nënshtrohet bllokimit administrativ për 90 (nëntëdhjetë) ditë me urdhër

të drejtuesit të zyrës së policisë kufitare kompetente. Shpenzimet e ruajtjes, të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Brendshëm, janë në ngarkim të kundërvajtësit.

5. Nëse dokumentet nuk paraqiten edhe brenda këtij afati, mjete lundrues konfiskohet.
6. Personat, që gjenden në bordin e mjetit lundrues pa dokument identifikimi, shoqërohen në zyrat e policisë kufitare për verifikimin e identitetit të tyre, në bazë të nenit 107 të ligjit nr.108, datë 31.07.2014 “Për policinë e Shtetit”.
7. Në rast se shkelja e parashikuar, në pikën 1, brenda 6 muajve përsëritet, sanksioni administrativ dyfishohet.
8. Në rast se shkelja, e parashikuar në pikën 1, përsëritet më shumë se dy herë brenda 1 viti, përveç sanksionit administrativ të parashikuar në pikën 7 zbatohet edhe dënimi plotësues i bllokimit të mjetit lundrues për 90 (nëntëdhjetë) ditë.
9. Oficeri ose agjenti i Policisë Kufitare, që ka bërë kontrollin, zbaton sanksionin e parashikuar në këtë nen duke respektuar procedurën e parashikuar.

Neni 16

Refuzimi për paraqitjen e dokumenteve

1. Refuzimi për paraqitjen e dokumenteve të parashikuara në nenin 5 përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, si dhe me bllokimin administrativ për 90 ditë të mjetit lundrues.

Neni 17

Mos deklarimi pas importimit

1. Mos deklarimi i importimit, siç parashikohet në pikën 1 të nenit 8, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe bllokim administrativ i mjetit lundrues për 180 ditë.
2. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare, që ka bërë kontrollin, zbaton sanksionin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni duke respektuar procedurën e parashikuar

Neni 18

Mos deklarimi i zotërimit ose i mbajtjes

1. Mos deklarimi në sistem i zotërimit ose i mbajtjes brenda afatit, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, si dhe me bllokim administrativ për 180 ditë.
2. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare, që ka bërë kontrollin, zbaton sanksionin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni duke respektuar procedurën e parashikuar

Neni 19

Mungesa e regjistrimit

1. Pronësia, mbajtja dhe përdorimi i një mjeti lundrues, objekt i këtij ligji, të paregjistruar, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 200.000 (dyqind mijë) lekë dhe bllokim administrativ prej 180 ditë.
2. Mos përmbushja e kushteve të regjistrimit brenda afatit prej 180 ditësh përbën vepër penale dhe mjeti lundrues konfiskohet.
3. Oficeri i policisë gjyqësore vë në dijeni Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe i dërgon prokurorit brenda dyzet e tetë orëve procesverbalin e sekuestrimit të mjetit lundrues, i cili brenda dyzet e tetë orëve në vijim vlerëson ligjshmërinë.

Neni 20

Ndryshimi ose falsifikimi i karakteristikave të mjetit

1. Ndryshimi ose falsifikimi i karakteristikave teknike të mjetit lundrues, i fuqisë së motorit ose të motorëve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë 100.000 (njëqind mijë) lekë dhe konfiskimin e mjetit.
2. Pronari, mbajtësi, zotëruesi dhe drejtuesi i mjetit lundrues nëse kanë kërkuar ndryshimin ose falsifikimin, përgjigjen për bashkëpunimin në kundërvajtjen penale të parashikuar në pikën 1.
3. Oficeri i policisë gjyqësore i dërgon prokurorit brenda dyzet e tetë orëve procesverbalin e sekuestrimit të mjetit lundrues, i cili brenda dyzet e tetë orëve në vijim vlerëson ligjshmërinë.

Neni 21

Përgjegjësia e fabrikave dhe e kantierëve detare

1. Shkelja e dispozitave të parashikuara nga pikat 1 e 2 të nenit 10 përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 100.000 (njëqind mijë)lekë.
2. Kur shkelja përsëritet më shumë se një herë, gjobës së parashikuar në pikën 1 i shtohet dënimi plotësues i mbylljes së fabrikës dhe të kantierit detar nga nëntëdhjetë, deri në njëqind e tetëdhjetë ditë.
3. Pronari dhe administratori i fabrikës ose i kantierit detar, nëse kanë urdhëruar zhvillimin e veprimtarisë së paligjshme, përgjigjen për bashkëpunimin në kundërvajtjen administrative të përmendur në pikën 1 dhe gjoba dyfishohet.
4. Mbyllja e përkohshme vendoset në çastin e kontrollit nga oficeri i policisë kufitare dhe në këtë rast zbatohet procedura e parashikuar për këtë qëllim.

Neni 22

Refuzimi i paraqitjes së regjistrave

1. Refuzimi nga pronari dhe administratori i fabrikës ose i kantierit detar për të paraqitur regjistrat, siç parashikohet në pikën 3 të nenit 10, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

2. Në rast se shkelja përsëritet, përveç gjobës me 50 000 lekë, bëhet mbyllja e përkohshme e fabrikës ose e kantierit nga 90 (nëntëdhjetë) deri në 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë.
3. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare që ka bërë kontrollin, zbaton sanksionin e parashikuar në pikën 1 dhe 2 të këtij neni duke respektuar procedurën e parashikuar

Neni 23

Mos deklarimi i ndryshimeve

1. Mos deklarimi i ndryshimeve të parashikuara në nenit 9 dënohet me gjobë 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
2. Në rast se shkelja e parashikuar në pikën 1 përsëritet, gjoba dyfishohet.
3. Kur shkelja e parashikuar në pikën 1 përsëritet më shumë se dy herë, gjoba dyfishohet dhe zbatohet dënimi plotësues i bllokimit administrativ të mjetit lundrues për nëntëdhjetë ditë.
4. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare që ka bërë kontrollin, zbaton sanksionin e parashikuar në pikën 1, 2 dhe 3 të këtij neni duke respektuar procedurën e parashikuar

Neni 24

Tejkalimi i numrit të personave që transportohen

1. Përveç sa parashikohet nga legjislacioni për lundrimin, transporti me mjetin lundrues i një numri personash, përfshirë ekuipazhin, më të lartë se ai i shënuar në lejen e lundrimit dhe në certifikatën e përdorimit, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me një gjobë prej 10.000 (dhjetë mijë) lekësh për çdo person mbi numrin e lejuar.
2. Tejkalimi i numrit të personave që mund të transportohet, me më shumë se dhjetë veta përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, si dhe me bllokim administrativ 90 ditë të mjetit lundrues.
3. Policia Kufitare, Roja Bregdetare që konstaton shkeljet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, shoqëron mjetin në portin më të afërt dhe i dorëzon Kapitanerisë procesverbalin e kundërvajtjes së konstatuar. Kapiteneria e portit ekzekuton masën administrative.

Neni 25

Përdorimi i mjetit lundrues për veprimtari të kundërligjshme

1. Në rast se mjeti konstatohet duke kryer veprimtari të kundërligjshme në fushën e terrorizmit, trafikut të qenieve njerëzore, trafikut të lëndëve narkotike, të armëve, të lëndëve kimike dhe radioaktive, transporti i kundërligjshëm i mjeteve monetare përbën veprë penale dhe mjeti lundrues konfiskohet.
2. Në çdo rast sekuestrohet edhe mjeti i përdorur për transportin e mjetit lundrues nga e për në vendin e përdorimit të mjetit lundrues.
3. Oficeri i policisë gjyqësore i dërgon prokurorit brenda dyzet e tetë orëve procesverbalin e sekuestrimit të mjetit lundrues, i cili brenda dyzet e tetë orëve në vijim vlerëson ligjshmërinë.

Neni 26

Shkelja e kalimit paqësor

1. Shkelja e kalimit paqësor përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në vlerën prej 200,000 (dyqind mijë) lekë, për sa kohë nuk përbën vepër penale.
2. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare ose i Rojës Bregdetare që ka bërë kontrollin, zbaton sanksionin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni duke respektuar procedurën e parashikuar

Neni 27

Shkelja e rregullave në plazhe, zona ujore dhe nënujore

1. Shkelja e kushteve për ushtrimin e aktivitetit të rregullt e të sigurt me mjetet lundruese dhe për mënyrën e përdorimit të tyre për qëllime argëtimi e sportive, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 100 000 (njëqind mijë), si dhe me bllokimin administrativ për 90 (nëntëdhjetë) ditë të mjetit lundrues.
2. Drejtimi i mjetit lundrues nën efektin e pijeve alkoolike dhe substancave psikotrope përbën kundërvajtje penale. Drejtuesi i mjetit lundrues dënohet me gjobë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, heqje të dëshmisë së aftësisë për drejtimin e mjetit lundrues për 6 (gjashtë) muaj.
3. Zhytja e pa autorizuar në objektet historike dhe kulturore nënujore të paautorizuara konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në vlerën 300,000 (treqind mijë) lekë.

PJESA E TETË

Neni 28

Pjesët e mjeteve lundruese

1. Dispozitat e parashikuara në sanksionet e këtij ligji zbatohen edhe kur bëhet fjalë për pjesë të mjeteve lundruese të cilat, në bazë të të dhënave të bazuara, të vendndodhjes, të mënyrës së fshehjes në ngarkim të pronarit ose të bashkëpronarëve, të mbajtësit ose të zotëruesit, që janë të destinuara për formimin, ndryshimin ose montimin e mjeteve lundruese.

PJESA E NËNTË

Neni 29

Lidhja me Kodin Penal dhe me ligjet e tjera të veçanta

Përveç sanksioneve të përmendura në shkeljet e veçanta të këtij ligji, zbatohen edhe ato të parashikuara nga Kodi Penal dhe nga ligjet e tjera të veçanta, në rastet kur me përdorimin e mjetit lundrues sipas nenit 2 kryhen vepra penale.

Neni 30

Zbatimi i Kodit të Procedurës Penale

Përveç procedurave të parashikuara në këtë ligj, zbatohen edhe nenet e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 31

Ruajtja gjyqësore e mjeteve të sekuestruara e të konfiskuara

Mjetet lundruese, të sekuestruara e të konfiskuara në bazë të këtij ligji, i besohen në ruajtje Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit

Neni 32

Përdorimi i mjeteve të konfiskuara

1. Mjetet lundruese që kanë kryer shkeljet e parashikuara në nenin 25, pasi konfiskohen bëhen pronë e shtetit.
2. Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, sipas akteve ligjore, me kërkesë të Departamentit për Kufirin e Migracionin dhe me miratim të organeve përgjegjëse, mjetet lundruese të konfiskuara, ia jep në përdorim zyrave të policisë kufitare për kryerjen e detyrave institucionale.

Neni 33

Ankimi administrativ

1. Ndaj masave administrative me gjobë dhe bllokim administrativ, të marra në bazë të këtij ligji, kundërvajtësi mund të bëjë ankim brenda 5 ditëve te Drejtuesi rajonal në zonën e kompetencës juridike, i cili vendos brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së ankimit.
2. Ndaj masës administrative të sekuestrimit, të marrë në bazë të këtij ligji, kundërvajtësi mund të bëjë ankim brenda 5 ditëve te Drejtuesi i institucionit qendror shtetëror, i cili vendos brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit.
3. Ndaj vendimeve të marra, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, kundërvajtësi mund të bëjë ankim në gjykatën kompetente, në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 34

Aktet nënligjore të ligjit

1. Brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji ministria përgjegjëse për transportin dhe ministria përgjegjëse për Policinë e Shtetit do të nxjerrin një udhëzim të përbashkët për funksionimin e regjistrit elektronik të mjeteve lundruese dhe modalitetet e shkëmbimit të informacionit me institucionet e tjera ligjore.

2. Brenda gjashtëdhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ministria përgjegjëse për Policinë e Shtetit do të miratojë udhëzimin për rregullat dhe mënyrën e zbatimit të sanksioneve administrative.
3. Brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji ministritë që ngarkohen për zbatimin e këtij ligji do të nxjerrin çdo akt tjetër nënligjor të nevojshëm për zbatimin e këtij ligji.

Neni 35

Dispozitat kalimtare

1. Deri në ngritjen e regjistrit elektronik të mjeteve lundruese, institucionet ngarkohen në shkëmbimin periodik të informacionit.

Neni 36

Dispozitat përfundimtare

1. Dispozitat e ligjit nr.7873, datë 16.11.1994 “Për sekuestrimin e mjeteve tokësore, detare dhe ajrore me të cilat kryhen vepra penale” nuk zbatohen për mjetet lundruese objekt i këtij ligji.
2. Deri në ngritjen dhe funksionimin e Regjistrit Elektronik i Mjeteve Lundruese do të zbatohen Nenet 7 dhe 9 të parashikuara në ligjin nr.8663, datë 18.09.2000 “Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me tonazh nën 20 NT” i ndryshuar.
3. Ligji nr.8663, datë 18.09.2000 “Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT” i ndryshuar shfuqizohet.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI